



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË
AMBASADËS AUSTRIAKE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.06.2019 me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të paraqitur nga Ambasada Austriake për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"



Nr. 907 i Vendimit Data 28.06.2019 Ora 10.⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Ambasadës Austriake për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.

V Ë R E N

Ambasada Austriake ka paraqitur kërkesën e saj me nr.Prot 12487 të datës 27.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Austriake për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019, sipas listës së përcaktuar në lidhjet Nr.01 dhe Nr.02, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund te bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 907 i Vendimit Data 28.06.2019 Ora 10.⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Ambasadës Austriake për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019.